A.K.P.A.
Nr 805 Prot.
Datë,më 12 03 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT**
**AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**
**QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK GJIROKASTËR**

**Nr.** 117/3 **prot** **Data** 10.3.2026

**Lënda**: Njoftim për vend të lirë

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE**
**DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.
Ofruesi publik AFP-se QFPP Gjirokaster ju njofton krijimin e vendit te lire per pozicionin/pozicionet

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. Instruktor/e për kursin | Pasticeri | 1 person | (Gjirokaster) |
| 2. Instruktor/e për kursin | Mobileri | 1 person | (Gjirokastër) |
| 3. Instruktor/e për kursin | Kujdestar Femijesh | 1 person | (Gjirokastër) |
| 4. Instruktor/e për kursin | Kuzhine | 1 person | (Libohove) |
| 5. Instruktor/e për kursin | Kujdestar Social | 1 person | (Gjirokastër) |
| 6. Instruktor/e për kursin | Parukeri | 1 person | (Permet) |
| 7. Instruktor/e për kursin | Saldim | 1 person | (Gjirokaster) |
| 8. Instruktor/e për kursin | Rrobaqepsi | 1 person | (Gjirokaster) |
| 9. Instruktor/e për kursin | Instalim dhe mirembajtje e rrjetit elektrik | 1 person | (Gjirokaster |

**1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

**Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:**

a) të ketë zotësi tëplotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të forms së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj ti jmasa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

**Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:**
a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale,pas të mesme ose parauniversitare në te njejten fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
b) të ketë të paktën 3 (tre ) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

**2. Dokumentet e aplikimit**

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicioni:
b) jetëshkrimin (CV-në);
c) kartën e identitetit;
d) diplomën
e) librezën e punës;
f)çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore:
j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm;
- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesittë AFP-së, Brenda datës 24/03/2026

3.Vleresimi I kandidateve do behet referuar percaktimeve te udhezimit nr.759,date 30.09.2024,"Per menyren e organizimit dhe veprimtarise,menaxhimin e burimeve njerezore,perberjen e njesise se zhvillimit te institucioneve,ofruesve te arsimit dhe formimit professional dhe zhvillimit te vazhduar professional te personelit", i ndrushuar.

**DREJTOR**

**Mihane LAPA**